

## AKTI I THEMELIMIT I SHOQÉRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “CAS” sh.p.k

Themeluesi që nënshkruan më poshtë është si vijon:

Z. Musa Ahmeti, i datëlindjes 21/08/1963, i biri i Imer-it, lindur në Ponoshec/Kosovë dhe banues në Vasil Taja 00910557; Nd. 6; H. 1; Elbasan 3001; Elbasan, identifikuar me letërnjoftim nr.032280542 dhe nr. personal G30821130E, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

Që në vijim do të quhet Ortaku i Shoqërisë “CAS” sh.p.k

Sot, më datë 22. 05. 2023, bazuar në vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, vendosi të themelojë Shoqërinë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar, në bazë të kushteve që vijojnë:

**Kreu I**  
**OBJEKTI, EMËRTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**  
**Neni 1**  
**Objekti i shoqërisë**

Shoqëria Tregëtare “CAS” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

- Shtëpi botuese, botime të ndryshme në fushën e letërsisë artistike, kulturore, shkencore, filozofike, fetare, informative, sportive dhe të ilustruara, fletë palosje, etiketa.
- Tregtimi të makinerive dhe pajisjeve poligrafike, litografke kompjuterike, pajisje elektronike, letër, bojë, artikuj kancelarikë, shpërndarja e botimeve dhe artikujve të mësipërm.
- Shërbimet e dizajnit dhe promocionit.
- Shërbime dhe konsulenca në fushën e arsimit dhe të edukimit, trajnimit dhe përgatitjes profesionale.
- Tregtia e librit online dhe në forma të tjera.
- Ndërtim i Bibliotekave dixhitale për individë apo institucione arsimore e kultutore
- Realizim i Arkivave dixhitale
- Ndërtimi dhe menaxhimi i Platformave online, portaleve dhe faqe interneti.
- Shpërndarja e librit në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë (Europë, Amerikë, Azi etj.).
- Edukimi profesional dhe gjuhësor për të gjitha moshat dhe profesionet.
- Mësimi dhe trajnimi për gjuhët e huaja në prani dhe online.
- Përgatitje dhe mbrojtje e provimeve te njohura ndërkombëtarisht të vlerësimit të gjuhëve: gjermane, angleze, italiiane, hungareze, frëngje dhe gjuhëve sllave në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë të liçencuar e specializuar në këto fusha.
- Tregëtimi dhe vënia në shërbim i materialeve mësimore dhe metodave si për mësimin e gjuhëve të lartëcitaura dhe për përgatitje dhe njohje të specializuar për të gjitha fushat.
- Trajnimi dhe përgatitja profesionale e kuadrit për të punuar në vend dhe jashtë vendit nga fushat e mjekësisë, infermierisë, bujqësisë, turizmit, transportit, gastronomisë, ndërtimtarisë etj.
- Shërbimet e ndërmjetësimit në tregun e punës dhe formimit profesional.
- Ndërmjetësimet në tregun e punës (Agjensi private punësimi e ndërmjetësimi) brenda dhe jashtë Shqipërisë personelit të kualifikuar.
- Asistencë për studentë, kërkues shkencorë dhe akademikë për të plotësuar dokumentet përkatëse apo për të aplikuar në programe studimi e trajnimi, përfitimin e bursave etj.
- Përkthime në gjuhë të ndryshme.
- Ofrimin e ekspertizës dhe asistencës në shkrimin dhe menaxhimin e projekteve europiane për Shoqata, Institucione arsimore, OJF, Biznese, Institucione vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe ndërtimin e partneriteteve të këtyre subjekteve me partnerë europiane të fushave të tyre.
- Bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në fushat e lartëcitaura.



- Shërbime profesionale në fushën e analizës dhe konsulencës financiare dhe administrative, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe këshillimit juridik.
- Shoqëria mund të lidhë kontrata qiraje, shitblerje, marrëveshje përvendosje hipoteke mbi pasuritë e paluajtshme, marrëveshje huadhenj apo financimi, marrëveshje për ofrimin e shërbimeve dhe çdo marrëveshje tjeter që konsideron të nevojshme përvembushjen e objektivit të saj.
- Shërbime marketingu në fushën e arsimit, kulturës, historisë e gjuhës së.
- Organizimi i konferencave vendore e ndërkombëtare përvashat e lartëcitura, workshopë, trajnime etj.
- Themelon e boton gazeta, revista e periodikë të tjera në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.

### Neni 2

#### Emërtimi dhe Selia Juridike e Shoqërisë

Ortaku vendosi që shoqërinë t'a emërojnë "CAS" sh.p.k

Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në Njësia Administrative Nr. 10, Rruga e Bogdanëve, Ndërtesa 24, Hyrja 2, Apartamenti 1, Kodi postar 1001, Tiranë

Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

### Neni 3

#### Forma Juridike

1. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi
2. Me vendim të ortakut mund të ndryshojë formën juridike të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijojen premissa më të favorshme përfunksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast ortaku do t'a përshtasë Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjë regjistrimin e saj në regjistrin tregtar, në organet kompetente shqiptare.
3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.
4. Shoqëria do të ketë vullën e saj.

### Kreu II

#### TË DREJTAT DHE DETYRAT, KOHËZGJATJA

#### Neni 4

##### Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakut

1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak në një shoqëri tjeter ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.
5. Ortaku merr pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nëpërmjet përfaqësuesëve të tij.
6. Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha informata që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregëtare të shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike etj.

### Neni 5

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar.

**Kreu III  
KAPITALI THEMELTAR**

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar është 100.000 (njëqind mijë) Lekë. 1 (një) kuotë gjithësej.

Ortaku i shoqërisë është:

1. Musa Ahmeti, zotëruesh i 1 (një) kuote me vlerë 100.000 lek, që përfaqëson 100% (njëqind përqind) kapitalin themeltar të shoqërisë;

**Kreu IV  
PERSONALITETI JURIDIK**

Neni 7

Shoqëria fiton personalitetin juridik në ditën e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe fillon veprimtarinë e saj me marrjen e licencës të ushtrimit së veprimtarisë.

**Kreu V  
ADMINISTRIMI**

Neni 8

Shoqëria do të administrohet nga administratori Denis Zavalani i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëni me të tretët për një periudhë **5 (pesë)** vjeçare dhe me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.

**Kreu VI  
DISPOZITA TË TJERA**

Neni 9

Fitimi i realizuar nga Shoqëria, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut të tij, t'a ndajë si divident apo t'a shtojë në kapitalin e shoqërisë.

Ky Akt shtypet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Tiranë më 22. 05. 2023

Ortaku Themelues

Musa AHMETI

